

Vendim nr. 55 datë 10.07.2024
(V-55/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Blerina Çinari, në datat 21.06.2024 dhe 25.06.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 4 (Nj) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JO MË PAK SE NJË E DHJETA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,**
JO MË PAK SE NJË E PESTA E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
të përfaqësuar nga deputeti Gazmend Bardhi dhe avokati Marash Logu, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga avokate Artemida Hoxhaj, me autorizim.

DEPUTETJA OLTA XHAÇKA, përfaqësuar nga avokati Genci Çifligu, me prokurë.

OBJEKTI: **Kundërshtimi i vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese” dhe deklarimi i këtij vendimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Zgjidhja e konfliktit të kompetencave ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10 e deputetëve, duke përcaktuar mënyrën kushtetuese konkrete se si zgjidhet ky konflikt dhe se si ushtrohet e drejta

kushtetuese e pakicës parlamentare (një të dhjetës së deputetëve) për të mos u penguar mocioni i saj nga Kuvendi në kushtet e mosverifikimit të pengesave formale, në kushtet kur mazhoranca, me votim, ka vendosur moszbatimin e vendimit nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese dhe kjo mund të ripërsëritet në të ardhmen.

Interpretimi përfundimtar i neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 70, 71, 73, 124, 131, pika 1, shkronja “ç”, 132 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, 50, 51 dhe 66 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve dhe jo më pak se 1/5-ta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*kërkuësit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe deputetes Olta Xhaçka, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 20.06.2022 një grup prej 14 deputetësh të pakicës parlamentare, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, i është drejtuar Kuvendit me mocion, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka (*mocioni i parë*), duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70,

pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, me argumentet se shoqëria tregtare në pronësi të bashkëshortit të saj dhe, për rrjedhojë, edhe të deputetes në fjalë, ka përfitur të drejta pasurore nga pasuri të shtetit.

2. Në datën 01.07.2022 një grup tjetër prej 15 deputetësh, po të pakicës parlamentare, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, ka depozituar në Kuvend një kërkesë për mocion drejtuar Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin (*Këshilli për Mandatet*) me të njëjtin objekt dhe argumente mbështetëse (*mocioni i dytë*).

3. Mocionet janë bashkuar, duke u shqyrtuar në një procedurë të vetme nga Këshilli për Mandatet. Në përfundim të shqyrtimit, pakica dhe shumica parlamentare në këtë këshill kanë prezantuar raportet përfundimtare, duke dalë me qëndrime të kundërta rreth plotësimit të kriterëve kushtetuese për dërgimin nga Kuvendi të çështjes në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*). Raportet i kanë kaluar për shqyrtim seancës plenare të Kuvendit, i cili, me vendimin nr. 83, datë 17.11.2022 (*vendimi nr. 83/2022*), ka vendosur mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare, kurse me vendimin nr. 84, datë 17.11.2022 (*vendimi nr. 84/2022*) ka vendosur miratimin e raportit të shumicës parlamentare, sipas të cilit nuk plotësohen kriteret kushtetuese të parashikuara në nenin 70, pika 3, të Kushtetutës për vënien në lëvizje të Gjykatës, sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës. Në këtë mënyrë Kuvendi nuk e ka dërguar çështjen në Gjykatë.

4. Me kërkesën e datës 18.11.2022, një grup prej 14 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes këtij subjekti dhe Kuvendit, si rrjedhojë e vendimeve të këtij të fundit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, si dhe deklarin e tyre të papajtueshme me Kushtetutën (*çështja e parë*).

5. Po në të njëjtën datë, një grup tjetër prej 28 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, i janë drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Ota Xhaçka (*çështja e dytë*).

6. Për çështjen e parë, me vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 (*vendimi nr. 1/2023*), Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit dhe subjektit kushtetues në konflikt jo më pak se 1/10-ta e deputetëve dhe shfuqizimin e vendimeve të Kuvendit nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022, si të papajtueshme me Kushtetutën. Sipas Gjykatës, çështja e vlerësimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit

të deputetes Olta Xhaçka i takon vlerësimit të Gjykatës, pasi faktet kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuesit dhe t'ia dërgonte asaj çështjen për shqyrtim, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues. Vendimi ka hyrë në fuqi në datën 28.02.2023, me botimin e tij në Fletoren Zyrtare nr. 32 të vitit 2023.

7. Për çështjen e dytë, me vendimin nr. 2, datë 23.01.2023 (*vendimi nr. 2/2023*), Gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit. Duke konstatuar se çështja kishte në objektin e saj dy kërkime, në lidhje me kërkimin e parë Gjykata ka vlerësuar se ai ka mbetur pa objekt, në kushtet kur vendimet objekt kërkese ishin shfuqizuar me vendimin e saj nr. 1/2023. Ndërsa për kërkimin e dytë, Gjykata ka vlerësuar se nuk kishte juridiksion për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, kurse pretendimet sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës kishin marrë përgjigje me vendimin nr. 1/2023, duke vlerësuar se ato përfshiheshin në juridiksionin e saj, por se ky juridiksion nuk ishte aktivizuar ende për sa kohë Kuvendi nuk ia kishte dërguar çështjen asaj. Vendimi ka hyrë në fuqi po në datën 28.02.2023, me botimin e tij në të njëjtën Fletore Zyrtare.

8. Në datën 10.03.2023, bazuar në nenin 87 të Rregullores së Kuvendit, Kryetarja e Kuvendit ia ka përcjellë Këshillit për Legjislacionin vendimet nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023 të Gjykatës. Në mbledhjet e këtij këshilli është diskutuar rreth qëndrimit të mbajtur nga Gjykata në këto vendime dhe, në kushtet kur midis përfaqësuesve të pakicës dhe shumicës parlamentare në këshill ka pasur qëndrime të ndryshme për detyrimet e përcaktuara nga Gjykata në vendimet e saj, me shumicën e anëtarëve të tij është vendosur caktimi i një eksperti të së drejtës kushtetuese për t'iu përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të këshillit në lidhje me këto vendime. Opinioni i ekspertit u është bërë i njohur anëtarëve në datën 27.06.2023, ndërsa në datën 07.07.2023 këshilli ka përgatitur raportin e tij për zbatimin e vendimeve të Gjykatës për çështjen e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, i cili i është dërguar në vijim Kryetares së Kuvendit. Raporti nuk përmbante rekomandime, por vetëm analizë të vendimeve të Gjykatës që bazohet në interpretime të caktuara të normave kushtetuese e ligjore dhe qëndrimeve interpretuese të Gjykatës në lidhje me to. Në raport pakica parlamentare ka mbajtur qëndrimin se çështja duhej t'i kalonte seancës plenare për të vendosur dërgimin e saj në Gjykatë, ndërsa shumica parlamentare ka mbajtur qëndrimin se përpara se t'i kalonte seancës, çështja duhej të

shqyrtohej nga Këshilli për Mandatet, si struktura kompetente e parashikuar nga neni 119/1 i Rregullores së Kuvendit.

9. Këshilli për Mandatet në mbledhjen e datës 08.04.2024 ka diskutuar mocionin për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka. Në datat 09.04.2024 dhe 10.04.2024, respektivisht, deputetët e pakicës dhe të shumicës parlamentare kanë paraqitur raportet e tyre në lidhje me mocionin dhe zbatimin e vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës, ndërsa është kërkuar që çështja t'i kalojë për shqyrtim seancës plenare. Kësaj të fundit, deputetët e pakicës i kanë kërkuar që të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë, kurse deputetët e shumicës nuk kanë bërë rekomandime.

10. Me vendim të Kryetares së Kuvendit, projektvendimi “Mbi raportet e shumicës dhe pakicës së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe të mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” është bërë pjesë e rendit të ditës së punimeve të Kuvendit të datës 11.04.2024. Në seancën plenare të kësaj date, me vendimin nr. 41/2024, datë 11.04.2024 (*vendimi nr. 41/2024*), Kuvendi, me shumicën e votave, ka vendosur mosdërgimin në Gjykatë të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

11. Në datën 24.04.2024 një grup prej 44 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjekteve kushtetuese jo më pak se 1/10-ta dhe jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, sipas objektit të saj.

12. Në datën 14.05.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike. Në vijim, në kontekst të rrethanave të rastit dhe referuar edhe kërkesës së kërkuarit, Gjykata konsideroi shqyrtimin e çështjes me përparësi, pas përgatitjes së saj për gjykim, duke garantuar të drejtat procedurale të palëve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. *Kërkuarit, jo më pak se 1/10-ta dhe jo më pak se 1/5-ta e deputetëve të Kuvendit*, i janë drejtuar Gjykatës me pretendime të ndryshme mbi të cilat mbështesin kërkimet e tyre dhe më konkretisht:

13.1. *Kërkuari jo më pak se 1/10-ta e deputetëve* ka pretenduar se vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit ka krijuar *mosmarrëveshje kompetence* mes tij dhe Kuvendit në lidhje

me të drejtën për të kërkuar shqyrtimin e papajtueshmërisë me mandatin të deputetes Olta Xhaçka nga Gjykata, duke parashtruar se ai cenon:

13.1.1. *Nenin 70, pika 1, të Kushtetutës*, pasi, duke u fshehur pas parimit të mandatit të lirë (jodetyrues) të parashikuar në nenin 73, pika 1, të Kushtetutës, Kuvendi i ka shtrirë efektet e parimit të mandatit jodetyrues të deputetit për të bërë të paaplikueshëm detyrimin për të zbatuar vendimet e Gjykatës, duke cenuar në këtë mënyrë nenin 132 të Kushtetutës.

13.1.2. *Nenin 70, pika 4, të Kushtetutës*, pasi ka kufizuar të drejtën e jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për të vënë në lëvizje procesin kushtetues të kontrollit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Institucionalizimi i pushtetit të pakicës parlamentare, i materializuar në të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, është bërë nga kushtetutëbërësi me qëllim shmangien e qëndrimeve politike nga ana e shumicës parlamentare. Nëse do të pranohej një interpretim i ndryshëm, pakica parlamentare do të diskriminohej në raport me shumicën parlamentare, për sa kohë që ushtrimi i kësaj të drejte kushtetuese do të ishte në diskrecionin e kësaj të fundit.

13.1.3. *Standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës*, të garantuar nga neni 132 i Kushtetutës, nga i cili nuk përjashtohet as Kuvendi. Vendimi i kundërshtuar vendos një precedent të rrezikshëm, pasi krijon puç kushtetues institucional të tillë që vë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit demokratik. Neni 4 i Kushtetutës e lë në diskrecionin e organeve shtetërore interpretimin e Kushtetutës dhe mënyrën e zbatimit drejtpërdrejt të saj, por nuk u njeh atyre të drejtën e interpretimit përfundimtar, i cili bëhet nga Gjykata. Edhe pse me vendimin nr. 1/2023 Gjykata ka përcaktuar detyrimin e Kuvendit për t'i dërguar asaj çështjen e vlerësimit të pretendimeve të pakicës parlamentare në lidhje me pajtueshmërinë me mandatin të deputetes Olta Xhaçka për shkaqe që kanë të bëjnë me nenin 70, pika 3, të Kushtetutës, me vendimin nr. 41/2024, duke interpretuar vetë dispozitat kushtetuese, Kuvendi ka vendosur, sërish, mosdërgimin e çështjes në Gjykatë, me qëllim pengimin e zbatimit të vendimit nr. 1/2023 të saj. Duke keqinterpretuar dispozitat kushtetuese

dhe rolin e tij, Kuvendi ka vënë në pikëpyetje autoritetin e Gjykatës, duke i mohuar asaj ushtrimin e kompetencave që i njeh Kushtetuta.

13.1.4. *Parimin e zgjidhjes së konfliktit mes pushteteve përmes drejtësisë kushtetuese*, pasi në mënyrë të përsëritur mazhoranca i ka mohuar pakicës parlamentare të drejtën kushtetuese që t'i drejtohet Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, me qëllim sigurimin e ushtrimit të të drejtave të saj. Shqyrtimi nga Gjykata i së njëjtës çështje ndërmjet të njëjtave palë nuk përbën *res judicata*, pasi në rastin konkret bëhet fjalë për pretendime të reja për antikushtetutshmërinë e pretenduar.

13.1.5. *Parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve*, për shkak të mosmarrëveshjes së kompetencave të krijuar midis subjekteve kushtetuese brenda të njëjtit pushtet, jo më pak se 1/10-ës së deputetëve, nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër. Edhe pse në përmbajtjen e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është përdorur termi “*është i detyruar*”, kjo nuk nënkupton se vlerësimi në këtë rast është në kompetencë të Kuvendit. Nëse do të pranohej një pushtet i tillë i pakufizuar i Kuvendit, atëherë parashikimi kushtetues do të zhvishej nga qëllimi i tij, çka do të përbënte abuzim me pushtetin e shumicës.

13.2. ***Kërkuesi jo më pak se 1/5-ta e deputetëve*** ka kërkuar *interpretimin përfundimtar të neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës*, duke pretenduar se:

13.2.1. Vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit bën të nevojshëm interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese, si dhe të raportit ndërmjet tyre. Gjykata duhet të përcaktojë nëse parimi i mandatit të lirë (jodetyrues), i sanksionuar në nenin 70, pika 1, të Kushtetutës, shtrihet edhe ndaj vendimeve të saj; nëse po, a cenon kjo parimet bazë të shtetit të së drejtës; cili është raporti i kësaj dispozite me nenin 132 të Kushtetutës; a ka deputeti liri të votojë kundër zbatimit të vendimeve të Gjykatës dhe Kushtetutës. Po kështu, Gjykata duhet të përcaktojë se si respektohet e drejta e votës së lirë të deputetit, në kushtet kur neni 70, pika 1, i Kushtetutës përcakton se mandati i deputetit nuk është detyrues; në çfarë forme zbatohet ky parim për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave për

një mosmarrëveshje konkrete kushtetuese, në kushtet kur Kuvendi ka detyrimin për të çuar në Gjykatë mocionin e jo më pak se 1/10-ës së deputetëve; si sigurohet në këtë rast harmonizimi mes së drejtës së deputetit për mandat jodetyrues dhe së drejtës së jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për të mos u penguar mocioni i tyre nga Kuvendi në kushtet e mospasjes së pengesave formale, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës; cili është raporti mes nenit 73, pika 1 dhe nenit 132 të Kushtetutës; a mbulon parimi se “*deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit*” edhe rastet e pengimit ose moszbatimit të vendimeve të Gjykatës; a ka përgjegjësi deputeti, në kuptim të nenit 73, pika 1, të Kushtetutës, kur konstatohet që me dashje vendos me votë për moszbatimin ose pengimin e ekzekutimit të vendimit, sipas kuptimit që i kanë dhënë dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe neni 81 i ligjit nr. 8577/2000.

14. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka prapësuar:

14.1. *Për legjitimitimin e kërkesve:*

14.1.1. Kërkuesi jo më pak se 1/10-ta e deputetëve nuk legjitimohet, pasi vetëm 8 nga 44 deputetët kërkues janë të njëjtët që i janë drejtuar Kuvendit me mocion për të cilin në vijim është marrë vendimi nr. 1/2023 i Gjykatës. Deputetët që përfaqësojnë këtë subjekt nuk mund të pretendojnë se janë pjesë e një grupi parlamentar, pasi Kushtetuta nuk e njih një strukturë të tillë, dhe as se janë deputetë të opozitës ose të së njëjtës force politike, pasi ajo nuk i njih forcës politike të drejtën për të paraqitur mocion për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit.

14.1.2. Edhe kërkuesi jo më pak se 1/5-ta e deputetëve nuk legjitimohet, pasi vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit nuk ka prekur ose cenuar të drejtat e tij, për sa kohë as Kushtetuta, as ligji nuk i kanë njohur të drejtën për nisjen e procedurave parlamentare për dërgimin në Gjykatë të çështjes së konstatimit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Për sa kohë që nuk ka një mosmarrëveshje konkrete kushtetuese, kërkuesi nuk legjitimohet të kërkojë *in abstracto* interpretimin e dispozitave kushtetuese.

14.2. *Për pretendimet për vendimin nr. 41/2024 të Kuvendit:*

14.2.1. Kompetenca për të vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatë, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës dhe jurisprudencës kushtetuese, i takon vetëm Kuvendit, i cili nuk është i detyruar të vendosë në këtë mënyrë vetëm për shkak se është vënë në lëvizje nëpërmjet mocionit. Për sa kohë që Kushtetuta nuk u ka njohur kërkuarve të drejtën për të kërkuar drejtpërdrejt në Gjykatë konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, nuk mund të thuhet se ekziston një mosmarrëveshje kushtetuese mes këtyre subjekteve dhe Kuvendit.

14.2.2. Në zbatim të nenit 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës, Kuvendi ka shqyrtuar nëse mocioni i paraqitur nga jo më pak se 1/10-ta e deputetëve plotësonte kushtet formale të kërkuara dhe nuk ka analizuar në themel prova ose fakte, kompetencë që i takon Gjykatës. Pretendimet e kërkuarve në rastin konkret kishin të bënin me parashikimet e nenit 70, pika 2, të Kushtetutës dhe të neneve 21 e 24 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar (*ligji nr. 9367/2005*), të cilat nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, ndaj Kuvendi nuk mund të vendoste dërgimin e çështjes në Gjykatë. Për rrjedhojë, vendimi objekt kërkesë nuk është në kushtet e moszbatimit të vendimeve të Gjykatës. Arsyet që kanë shtyrë deputetët në marrjen e vendimit nuk mund të thuhet, elaborohen ose diskutohen prej tyre në seancë plenare, për rrjedhojë as të dihen, pasi vetë Gjykata ka përcaktuar se ky lloj mocioni nuk i nënshtrohet debatit parlamentar.

14.3. *Për interpretimin e dispozitave kushtetuese:*

14.3.1. Pika 1 e nenit 70 të Kushtetutës ka të bëjë me llojin e mandatit përfaqësues të deputetit dhe nuk gjen zbatim në rastin konkret, ndërsa pika 4 e këtij neni ka karakter procedural dhe ka të bëjë me rastin kur një situatë papajtueshmërie shqyrtohet nga Gjykata. As parashikimet e pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës nuk gjejnë zbatim në çështjen në shqyrtim, ndërsa pika 3 e këtij neni ka të bëjë me rastet kur vetë deputetët kryejnë veprimtari ekonomike që buron nga pasuria shtetërore ose e pushtetit vendor. Pra, parashikimi i kësaj të fundit referon te deputetët dhe jo tek të afërmit ose

personat e tjerë të lidhur me ta dhe puna e një të afërmi ose personi tjetër të lidhur me deputetin nuk quhet veprimtari në kuptim të dispozitës kushtetuese. Edhe sipas pikës 4 të nenit 70 juridiksioni i Gjykatës kufizohet vetëm në veprimtarinë që kryen vetë deputeti në mënyrë të drejtpërdrejtë, qasje që mbështetet edhe në analizë të punës përgatitore të komisionit për hartimin e Projektkushtetutës të datës 08.05.1998.

14.3.2. Kur vihet në lëvizje nga jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, Kuvendi shqyrton fillimisht nëse *prima facie* plotësohen kriteret e nenit 70, pika 3, të Kushtetutës për të dërguar çështjen në Gjykatë. Në këto raste Kuvendi nuk është thjesht noter që kthen mocionin në kërkesë për gjykim nga Gjykata, pasi, nëse do të ishte kështu, Kushtetuta do të parashikonte se Kryetari i Kuvendit ose jo më pak se 1/10-ta e deputetëve mund ta depozitonin kërkesën drejtpërdrejt në Gjykatë, pa qenë nevoja të ndiqej një procedurë në Kuvend. Edhe kur çështja rikthehet sërish në Kuvend, ky i fundit, si interpretuesi i parë i normës kushtetuese, vijon të gëzojë kompetencat për vlerësimin *prima facie* të mocionit.

15. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka prapësuar:

15.1. Për legjitimimin:

15.1.1. Sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, subjektit jo më pak se 1/10-ta e deputetëve i është njohur vetëm e drejta për të paraqitur mocion, i cili, në vetvete, përbën një propozim që i bëhet Kuvendit, i cili ka të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën. Për rrjedhojë, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve nuk përbën subjekt kushtetues, pasi nuk është veshur nga Kushtetuta me kompetenca për të vendosur për çështje konkrete. Neni 134 i Kushtetutës dhe neni 66 i ligjit nr. 8577/2000 i kanë njohur një të drejtë të tillë jo më pak se 1/5-ës së deputetëve.

15.2. Për pretendimet në lidhje me vendimin nr. 41/2024 të Kuvendit:

15.2.1. Vendimi i Kuvendit është marrë në përputhje të plotë me Kushtetutën, si për sa i përket kompetencës sipas pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, ashtu edhe për sa i përket ekzistencës së faktit të parashikuar nga pika 3 e këtij neni. Në rastin konkret nuk provohet ushtrimi prej deputetes i ndonjë veprimtarie fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit

vendor apo fitimi i pasurive të tyre, ndaj, duke mos qenë përpara ndalimeve të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Kuvendi nuk ka kompetencë të dërgojë çështjen në Gjykatë.

15.3. *Për interpretimin e dispozitave kushtetuese:*

15.3.1. Sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe, me mocion kuptohet një propozim ose kërkesë e një grupi deputetësh, pranimi ose jo i së cilës votohet nga Kuvendi dhe është kompetencë e këtij të fundit. Sipas nenit 70 të Kushtetutës, jo më pak se 1/10-ës së deputetëve i njihet e drejta për të vënë në lëvizje Kuvendin për çështje që lidhen me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit, për të cilën duhet të ketë një vendimmarrje nga Kuvendi, por ushtrimi i kësaj të drejte nuk përcakton vendimmarrjen e këtij të fundit. Kurse pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës kërkon që vetë deputeti, me veprimet e tij, të ketë kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor apo fiton pasuri të këtyre organeve dhe jo familjarët e tij, e pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese.

15.3.2. E drejta që i është njohur pakicës parlamentare për ngritjen e komisioneve hetimore nuk është e njëjtë dhe nuk mund të merret për analogji në rastin konkret. Formulimi “*është i detyruar*” në nenin 77 të Kushtetutës jo vetëm që vendos Kuvendin në një pozicion të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për ngritjen e komisionit hetimor, por institucionalizon pushtetin e pakicës parlamentare. Në ndryshim nga neni 77, pika 2, i Kushtetutës, neni 70, pika 4, i saj nuk e detyron Kuvendin të miratojë mocionin e pakicës dhe të vendosë për dërgimin e çështjes në Gjykatë.

III

Procesi në gjykimin kushtetues

16. Çështja është shqyrtuar në seancë plenare publike në datat 21.06.2024 dhe 25.06.2024, ku pasi ka administruar provat dhe ka dëgjuar konkluzionet përfundimtare të palëve, Gjykata ka deklaruar mbylljen e seancës plenare dhe është tërhequr për vendim.

17. Në datën 08.07.2024 subjekti i interesuar, Kuvendi, ka depozituar një kërkesë për riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, me qëllim kërkimin nga Gjykata të një opinionioni *amicus curia*

nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (*Komisioni i Venecias*) në lidhje me raportin midis demokracisë përfaqësuese parlamentare dhe rolit të Kuvendit në rastin e shqyrtimit të mocioneve për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Mbi këtë bazë, subjekti i interesuar ka kërkuar edhe pezullimin e shqyrtimit të çështjes deri në marrjen e opinionit *amicus curia*.

18. Pas shqyrtimit të kërkesës në datën 10.07.2024, Gjykata, me shumicë votash¹, vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit të interesuar. Ajo konstatoi se, referuar nenit 44/b të ligjit nr. 8577/2000, disponimi për kërkimin e një opinionit *amicus curia* dhe në këtë kuptim edhe paraqitja e një kërkesë të tillë nga palët, mund të bëhet gjatë shqyrtimit të çështjes, ndërkohë që në rastin konkret seanca plenare ishte mbyllur dhe Gjykata ishte tërhequr për vendim. Nga ana tjetër, Gjykata çmoi se nuk është rasti për riçeljen e seancës plenare sipas nenit 44 të atij ligji, në rrethanat kur kërkesa e subjektit të interesuar nuk kishte të bënte me sqarimin e ndonjë rrethane plotësuese me rëndësi të veçantë për çështjen.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

19. Gjykata vëren se në rastin konkret kërkesa është nënshkruar nga 44 deputetë që përfaqësojnë njëkohësisht jo më pak se 1/10-ën dhe jo më pak se 1/5-ën e deputetëve të Kuvendit, të cilët kanë vënë në lëvizje Gjykatën si subjekte të veçanta kushtetuese. Në objektin e kërkesës, por edhe në parashtrimet në seancë plenare, kërkuesi, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, ka kërkuar deklarinimin të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 41/2024 të Kuvendit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave të krijuar nga ky vendim mes këtij subjekti dhe Kuvendit, kurse kërkuesi, jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, ka kërkuar interpretimin përfundimtar të neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1, dhe 132, pika 1, të Kushtetutës.

20. Gjykata konstaton se në thelb të kërkesës është vënë në diskutim fuqia detyruese e vendimit të Gjykatës që ka përcaktuar detyrimin e Kuvendit për të iniciuar një proces kushtetues të kontrollit të papajtueshmërisë me Kushtetutën të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, çka ka qenë, sipas kërkuetit jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, edhe shkaku i lindjes së mosmarrëveshjes kushtetuese mes palëve, për rrjedhojë, sipas kërkuetit jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, ka sjellë edhe nevojën për interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese.

¹ Gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për pranimin e kërkesës, riçeljen e seancës plenare dhe marrjen e opinionit *amicus curia* nga Komisioni i Venecias.

Nisur nga kjo, për sa kohë kërkimi për interpretimin e disa dispozitave kushtetuese është qartazi në funksion të kërimit të parë, Gjykata do të ndalet fillimisht në trajtimin e kërkesës së jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për deklarimin të papajftueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 41/2024 të Kuvendit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave mes këtij subjekti dhe Kuvendit.

I. Për kërkesën e subjektit jo më pak se 1/10-ta e deputetëve

A. Për juridiksionin e Gjykatës

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, që përcakton funksionin themelor të saj dhe që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 2, datë 23.01.2023; nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 49, datë 03.07.2017; nr. 15, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, veprimet ose mosveprimet e organeve të përcaktuara në vendimin e Gjykatës për zbatimin e tij, mund të përbëjnë një çështje të re kushtetuese, nëse këto veprime ose mosveprime krijojnë mosmarrëveshje kushtetuese. Me fjalë të tjera, nga moszbatimi i vendimeve të Gjykatës mund të lindë një mosmarrëveshje e re kushtetuese. Por ky përcaktim i “mosmarrëveshjes/çështjes së re” varet nga rrethanat e çështjes, të cilat duhet të përmbajnë elemente të reja që nuk i janë nënshtruar më parë vlerësimit të Gjykatës dhe që i parashtrohen asaj në kontekstin e një çështjeje të re. Gjykata nuk ka juridiksion të shqyrtojë thjesht masën ose mënyrën se si po zbatohet një vendim i saj, nëse këto fakte, që duhet të përbëjnë elemente të reja, nuk janë të lidhura me objektin e një kërkesë të re kushtetuese, të parashtruar gjatë vënies në lëvizje të një gjykimi të ri kushtetues, në mbështetje të nenit 131, pika 1, të Kushtetutës. Kjo do të thotë se, pavarësisht rëndësisë që mund të mbartë një çështje e caktuar, Gjykata nuk mund të vihet kryesisht në lëvizje për të verifikuar nëse organet për të cilat kanë lindur detyrime nga vendimmarrja kushtetuese kanë vepruar në përputhje me atë arsyetim dhe urdhërim, në rast se para saj nuk parashtrohet për zgjidhje një mosmarrëveshje kushtetuese,

sipas kompetencave të përcaktuara nga neni 131 i Kushtetutës i lidhur me nenin 124 ose nene të tjera që parashikojnë kompetencën e saj.

23. Në këtë kuptim, neni 70, pika 4, i Kushtetutës ka përcaktuar juridiksionin kushtetues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencave, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, në rastet kur Kuvendi vendos mosdërgimin në Gjykatë të mocionit të jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit për shkeljet sipas nenit 70, pika 3, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret Gjykata vëren se me vendimin nr. 1/2023 ajo ka vendosur zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes jo më pak se 1/10-ës së deputetëve dhe Kuvendit, si rrjedhojë e vendimeve të tij nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 për të mos dërguar në Gjykatë çështjen e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, duke përcaktuar për Kuvendin detyrimin për dërgimin e çështjes në Gjykatë. Kurse me vendimin nr. 2/2023, Gjykata ka theksuar se juridiksioni i saj për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës aktivizohet vetëm me vendim të Kuvendit, në rast të një mocioni të 1/10-ës së deputetëve. Pas hyrjes në fuqi të këtyre vendimeve, Kuvendi, me vendimin nr. 41/2024, ka vendosur sërish mosdërgimin në Gjykatë të mocionit për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes në fjalë, vendim i cili është bërë shkak për paraqitjen nga kërkuesi të kërkesës objekt shqyrtimi.

25. Për rrjedhojë, për shkak të qëndrimit të Kuvendit të materializuar në vendimin e tij nr. 41/2024, mes subjektit jo më pak se 1/10-ta e deputetëve dhe Kuvendit është krijuar një konflikt i ri kompetencash. Ky konflikt është konkret dhe ka natyrë kushtetuese, çka ka krijuar një çështje të re kushtetuese, e cila, në referim të nenit 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, përfshihet në juridiksionin kushtetues.

B. Për legjitimitimin e kërkuesit

26. Kërkuesi jo më pak se 1/10-ta e deputetëve ka pretenduar, në thelb, se si subjekt në konflikt legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar si rrjedhojë e vendimit nr. 41/2024 të Kuvendit.

27. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se subjekti jo më pak se 1/10-ta e deputetëve nuk legjitimohet, pasi kërkesa nuk është nënshkruar nga të njëjtët deputetë që i janë

drejtuar Kuvendit me mocion për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhaçka, për të cilin në vijim është marrë vendimi nr. 1/2023 i Gjykatës.

28. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka prapësuar se subjekti jo më pak se 1/10-ta e deputetëve nuk legjitimohet, pasi këtij subjekti, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, i është njohur vetëm e drejta për të paraqitur mocion, që, në vetvete, përbën një propozim që i bëhet Kuvendit, i cili ka të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën. Për rrjedhojë, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve nuk përbën subjekt kushtetues, pasi nuk është veshur nga Kushtetuta me kompetenca për të vendosur për çështje konkrete. Neni 134 i Kushtetutës dhe neni 66 i ligjit nr. 8577/2000 i kanë njohur një të drejtë të tillë jo më pak se 1/5-ës së deputetëve.

29. Në jurisprudencën e saj, Gjykata është shprehur se grupet e deputetëve, të cilave norma kushtetuese u ka njohur të drejta si entitete, përfshirë edhe të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, nuk nënkuptojnë dhe nuk barazohen me organizimin politik të deputetëve apo partive politike që veprojnë brenda Kuvendit, por vetëm ai grupim që e ka ushtruar ose kërkon ta ushtrojë efektivisht këtë të drejtë (*shih vendimin nr. 42, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin e një konflikti kompetencash, midis palëve duhet të ekzistojë një marrëdhënie juridike në kuptimin kushtetues dhe nga kjo marrëdhënie të kenë ardhur pasoja të tilla që të kenë shkaktuar mosmarrëveshjen midis tyre (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 25, datë 08.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e saj, vlerëson se vetëm ai grupim deputetësh që pretendon se është penguar në ushtrimin e një të drejte kushtetuese institucionalizohet si një entitet i pavarur, i veshur me ato të drejta që kërkon të mbrojtë përmes kërkesës kushtetuese.

30. Gjykata ka theksuar se në rastin kur Kuvendi vihet në lëvizje me mocion të Kryetarit ose jo më pak se 1/10-ës së anëtarëve të tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatë, që është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetit (*shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 72, datë 07.12.2016; nr. 7, datë 24.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata vëren se procedura për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka në Kuvend është vënë në lëvizje përmes dy mocioneve të paraqitura nga jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, mocione këto që janë nënshkruar nga 29 deputetë gjithsej. Në vijim, Gjykata vëren se Këshilli për Mandatet ka vendosur t'i shqyrtojë mocionet në një procedurë të vetme parlamentare. Për rrjedhojë, referuar deputetëve konkretë

nënshkrues të mocioneve dhe atyre nënshkrues të kërkesës, Gjykata vëren se kërkesa për sa i përket kërkesit jo më pak se 1/10-ta e deputetëve mban nënshkrimin e të paktën 14 deputetëve të cilët kanë vënë në lëvizje edhe procedurën parlamentare për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka. Për sa më sipër, Gjykata çmon të pabazuar prapësimin e subjektit të interesuar, Kuvendit, për moslegjitimimin e kërkesit.

32. Gjykata, po ashtu, vëren se në mosmarrëveshjen e re të krijuar për ushtrimin e kompetencës kushtetuese për shkak të vendimmarrjes së kundërshtuar të Kuvendit, kërkesi jo më pak se 1/10-ta e deputetëve është palë në konflikt. Nisur nga kjo, pretendimet e kërkesit se vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit ka krijuar konflikt kompetence, kanë natyrë kushtetuese dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara parashikohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta, çka përbën argument të mjaftueshëm për të legjitimuar kërkesin në vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues në kuptim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon të pabazuar prapësimin e subjektit të interesuar, deputetes Olta Xhaçka, për moslegjitimimin e kërkesit.

33. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesi jo më pak se 1/10-ta e deputetëve legjitimohet *ratione personae* në lidhje me kërkimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës së krijuar mes tij dhe Kuvendit².

34. Kërkesi legjitimohet edhe *ratione temporis* në kuptim të nenit 55 të ligjit nr. 8577/2000. Shkaku i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave mes jo më pak se 1/10-ës së deputetëve dhe Kuvendit është bërë vendimi nr. 41/2024 i këtij të fundit, i cili mban datën 11.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 24.04.2024, pra brenda afatit 6-mujor për paraqitjen e kërkesës nga çasti i lindjes së konfliktit.

35. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkesi jo më pak se 1/10-ta e deputetëve ka pretenduar se vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit ka cenuar nenin 70, pikat 1 dhe 4, të Kushtetutës, standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës, parimin e zgjidhjes së konfliktit mes pushteteve përmes drejtësisë kushtetuese, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe parimin e ushtrimit të mandatit të deputetit në përputhje me parashikimet kushtetuese, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin

² Gjyqtarët Sonila Bejtja, Sandër Beci dhe Ilir Toska votuan për moslegjitimimin e kërkesit jo më pak se 1/10-ta e deputetëve, me të njëjtat argumente si edhe në qëndrimet e tyre në pakicë në vendimin nr. 1/2023 të Gjykatës. Me këtë qëndrim u bashkua edhe gjyqtarja Holta Zaçaj.

Gjyqtarët Holta Zaçaj dhe Ilir Toska në vijim, duke pasur parasysh se shkaqet në thelb të kërkesës kanë të bëjnë me moszbatimin e vendimit të Gjykatës, mbajtën qëndrimin se kërkesa duhet të trajtohej në themel në drejtim të natyrës dhe fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës, sipas përcaktimeve të nenit 132, pika 1, të Kushtetutës.

kushtetues. Gjykata vlerëson se për sa kohë që mosmarrëveshja e kompetencave mes palëve në konflikt pretendohet se ka ardhur si pasojë e moszbatimit të vendimit të saj nr. 1/2023, ajo do ta analizojë çështjen në kuptim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës të lidhur me nenin 132 të saj.

C. Për themelin e kërkesës

36. Kërkuesi jo më pak se 1/10-ta e deputetëve ka pretenduar se vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit ka kufizuar të drejtën tij për të iniciuar një proces kushtetues të kontrollit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, duke vënë në diskutim edhe fuqinë detyruese të vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës, me të cilin ajo ka përcaktuar detyrimin e Kuvendit për t'i dërguar çështjen e vlerësimit të themelit të pretendimeve të pakicës parlamentare në lidhje me papajtueshmërinë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, si çështje që i përket juridiksionit kushtetues. Sipas kërkuesit, Kuvendi, duke interpretuar vetë dispozitat kushtetuese, ka miratuar vendimin nr. 41/2024, me të cilin ka vendosur sërish mosdërgimin e çështjes në Gjykatë, me qëllim pengimin e zbatimit të vendimit të saj nr. 1/2023 me argumentin se deputetët e Kuvendit nuk mund të detyrohen të votojnë siç urdhëron Gjykata. Sipas tij, duke keqinterpretuar dispozitat kushtetuese dhe rolin e tij, Kuvendi ka vënë në pikëpyetje autoritetin e Gjykatës.

37. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se Kushtetuta nuk i ka njohur jo më pak se 1/10-ës së deputetëve të drejtën për të kërkuar drejtpërdrejt në Gjykatë konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, ndaj nuk mund të thuhet se ekziston një mosmarrëveshje kushtetuese mes këtij subjekti dhe Kuvendit. Po sipas Kuvendit, ai ka ushtruar kompetencën e tij në përputhje me parashikimet e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës e jurisprudencës kushtetuese dhe vendimi i tij objekt kërkesë nuk është në kushtet e moszbatimit të vendimeve të Gjykatës.

38. Subjekti i interesuar, deputetja Olta Xhaçka, ka prapësuar se në rastin konkret nuk ekziston një mosmarrëveshje kushtetuese, pasi neni 70, pika 4, i Kushtetutës i ka njohur vetëm Kuvendit të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën në rastin e paraqitjes së një mocioni për papajtueshmërinë me mandatin të deputetit. Sipas këtij subjekti, Kuvendi nuk ka detyrimin për të vendosur në këtë mënyrë vetëm për shkak se është vënë në lëvizje me mocion, ndërkohë që vendimi i tij është marrë në përputhje të plotë me Kushtetutën.

39. Gjykata vlerëson të rritheksojë qëndrimin e saj se vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues vetëm për rastin e verifikimit të papajtueshmërisë sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, konsiderohet një instrument kontrolli ndaj pushtetit ligjvënës që kërkon gjykim, gjë që del jashtë tagrave dhe mundësive të Kuvendit. Në rastet kur vihet në lëvizje, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Kuvendi nuk mund të vërë në diskutim mocionin e paraqitur dhe nuk mund t'ia nënshtrojë atë debatit parlamentar, por vendimmarrja e tij është në funksion të legjitimitetit të këtij organi si një nga subjektet që mund të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues. Kuvendi në këto raste nuk mund t'i hyjë themelit të çështjes, pra vlerësimin nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij, sepse në të kundërt do të ndërhynte në kompetencat që kushtetutëbërësi ia ka njohur vetëm Gjykatës (*shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka njohur autoritetin kushtetues të pavarur të pakicës parlamentare për të ushtruar kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta, të pakufizuar nga vullneti i shumicës (*shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 57, datë 23.07.2015; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, kushtetutëbërësi e ka ngritur në nivel kushtetues të drejtën e pakicës parlamentare për të kërkuar vënien në lëvizje të Gjykatës, si shprehje të ushtrimit të pushtetit të saj kontrollues ndaj shumicës parlamentare. Duke i dhënë asaj një mbrojtje kushtetuese, kushtetutëbërësi ka evituar ndërhyrjen e shumicës në ushtrimin e kësaj të drejte, si dhe diskrecionin e shumicës në interpretimin dhe vlerësimin e saj rast pas rasti (*shih vendimet nr. 1, datë 23.01.2023; nr. 7, datë 24.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Bazuar në standardet e mësipërme të jurisprudencës kushtetuese, me vendimin nr. 1/2023 Gjykata ka zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencave të krijuar mes jo më pak se 1/10-ës së deputetëve dhe Kuvendit, për shkak të rrëzimit nga Kuvendi të mocionit të këtij subjekti për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka. Gjykata ka rritheksuar në vendimin e saj se verifikimi dhe vlerësimi i kriterëve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre është një çështje që i përket Kuvendit, kurse vlerësimi i meritës së çështjes, pra nëse me veprimet e tij deputetja në fjalë ka shkelur ndalimin kushtetues të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës. Në vijim, me vendimin e saj nr. 2/2023 Gjykata ka theksuar se juridiksioni i saj për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e

mandatit të deputetit për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës aktivizohet përmes vendimmarrjes së Kuvendit.

42. Gjykata vëren se neni 3 i Kushtetutës parashikon si bazë të shtetit, me detyrën për ta respektuar dhe mbrojtur, edhe rendin kushtetues, ndërsa sipas nenit 4 Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë dhe dispozitat e saj zbatohen drejtpërsëdrejti, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Po kështu, sipas nenit 132, pika 1, të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

43. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj garantohet nga Kushtetuta, e cila në nenin 132 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare dhe, si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 49, datë 03.07.2017; nr. 15, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj (*shih vendimin nr. 17, datë 10.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata (*shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjykata vlerëson të ritheksojë fuqinë detyruese që Kushtetuta u ka dhënë vendimeve të saj, si e vetmja mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjeve me natyrë kushtetuese. Kjo natyrë e vendimeve të Gjykatës ka të bëjë jo vetëm me autoritetin e këtij organi kushtetues, por njëherazi garanton edhe epërsinë e Kushtetutës, duke detyruar organet e pushtetit publik që veprimtarinë e tyre ta zhvillojnë sipas kompetencave dhe brenda kufijve që ka caktuar vetë Kushtetuta. Moszbatimi i vendimeve të Gjykatës cenon të gjithë strukturën e të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në Kushtetutë, çka do të përbënte

një precedent të rrezikshëm, përveçse një tregues për nivelin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës.

46. Në vështrim të standardeve më sipër, Gjykata, në rastin konkret, do të verifikojë nëse Kuvendi ka zbatuar vendimin e saj nr. 1/2023 dhe, mbi këtë bazë, do të vlerësojë mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së parashtruar para saj.

47. Gjykata vëren se, referuar dokumenteve parlamentare të paraqitura në gjykim, pas hyrjes në fuqi të vendimit të saj nr. 1/2023, me të cilin ajo i ka kërkuar Kuvendit dërgimin asaj të çështjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, Këshilli për Legjislacionin, i vënë në lëvizje me vendim të Kryetares së Kuvendit, është mbledhur disa herë për të diskutuar në lidhje me zbatimin e vendimit në fjalë të Gjykatës. Anëtarët e pakicës parlamentare në Këshillin për Legjislacionin kanë mbajtur qëndrimin se në vendimin nr. 1/2023 Gjykata i ka dhënë të drejtë pakicës dhe jo shumicës parlamentare, ndaj Kuvendi duhej ta dërgonte çështjen në Gjykatë dhe zbatimi i këtij vendimi, në respektim edhe të nenit 132 të Kushtetutës, nuk mund të pengohet. Sipas tyre, projektvendimi për dërgimin e mocionit për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka duhej të përfshihej në rendin e ditës të seancës më të parë parlamentare. Kurse sipas kryetares së Këshillit për Legjislacionin, pjesë e shumicës parlamentare, shfuqizimi i vendimeve të Kuvendit nga Gjykata e kthente çështjen në pikën zero, te Këshilli për Mandatet, pasi nuk procedohej automatikisht dhe, sipas qëndrimit të Gjykatës, kërkesa të tilla nuk mund të shqyrtohen pa një vendim të Kuvendit. Në kuadër të shqyrtimit, me propozim të deputetes relatores të çështjes, shumica e anëtarëve ka vendosur marrjen e një opinionin në lidhje me problematikat e konstatuara në vendimet e Gjykatës në raport me jurisprudencën e mëparshme kushtetuese për çështje të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit dhe ndryshimet që neni 66 i ligjit nr. 8577/2000 ka pësuar me ligjin nr. 99/2016, duke thirrur për këtë një ekspert të së drejtës kushtetuese, i cili në vijim ka parashtruar opinionin e tij.

48. Në përfundim të diskutimeve, anëtarët e shumicës parlamentare në Këshillin për Legjislacionin kanë mbajtur qëndrimin se përpara se t'i dërgohej seancës plenare të Kuvendit, çështja duhej të shqyrtohej nga Këshilli për Mandatet, si struktura kompetente e parashikuar nga neni 119/1 i Rregullores së Kuvendit, ndërsa pakica parlamentare ka mbajtur qëndrimin se çështja i duhej dërguar seancës plenare. Në vijim, me vendim të Kryetares së Kuvendit është vendosur thirrja e mbledhjes së Këshillit për Mandatet.

49. Në raportin drejtuar Këshillit të Mandateve, anëtarët e pakicës parlamentare kanë mbajtur qëndrimin se përmes vendimit nr. 1/2023 është vendosur zgjidhja e mosmarrëveshjes së krijuar mes saj dhe Kuvendit, si rrjedhojë e vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të këtij të fundit. Sipas tyre, deputetja Olta Xhaçka ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, pasi përmes bashkëshortit të saj ka përfituar pasuri nga pasuria e shtetit, në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, çka duhet të sjellë edhe përfundimin e mandatit të saj. Ata kanë vërejtur se Kuvendi verifikon vetëm përmbushjen e kritereve formale dhe për sa kohë që ato plotësohen, ai ka detyrimin të dërgojë çështjen në Gjykatë. Në përfundim, pakica parlamentare ka vlerësuar se çështja duhej t'i kalonte për shqyrtim seancës plenare, e cila duhej të vendoste dërgimin e çështjes në Gjykatë.

50. Nga ana tjetër, sipas anëtarëve të shumicës parlamentare, në nenin 70, pika 4, Kushtetuta përdor termin “vendos” për Kuvendin, ndërsa në nenin 77, pika 2, termin “i detyruar”, terma të cilët, në këto norma, kanë qartësisht kuptime të ndryshme juridike. Sipas tyre, dallimi ndërmjet këtyre termave ka rëndësi edhe për respektimin e nenit 70, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilit mandati i deputetit nuk është detyrues, çka nënkupton të drejtën e deputetit të ndjekë bindjet e tij. Një gjë e tillë, sipas tyre, është theksuar edhe në vendimin nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës, si dhe nga Komisioni i Venecias. Po sipas anëtarëve të shumicës parlamentare, me vendimin nr. 1/2023 Gjykata është shprehur se mocioni është instrument për të vënë në lëvizje Kuvendin për të diskutuar për një çështje dhe se në përfundim është Kuvendi ai që vendos. Pra, këshilli nuk mund të bëjë një vlerësim të ri, pasi në vendimin nr. 1/2023 Gjykata është shprehur se gjatë gjykimit kushtetues të çështjes nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi, në respektim të nenit 132 të Kushtetutës. Nisur nga kjo situatë, sipas tyre, këshilli nuk mund të ushtrojë kompetencën e tij të parashikuar nga neni 119/1 i Rregullores së Kuvendit, ndaj në këto kushte, çështja mbetet në vlerësimin e seancës plenare, si organi vendimmarrës i Kuvendit.

51. Në seancën plenare të datës 11.04.2024 Kuvendi ka diskutuar projektvendimin “Mbi raportet e shumicës dhe pakicës së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe të mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, ku përfaqësuesi i pakicës parlamentare ka mbajtur qëndrimin se shumica parlamentare ka injoruar vendimin nr. 1/2023 të Gjykatës, kurse përfaqësuesi i shumicës parlamentare ka mbajtur qëndrimin se kur në jurisprudencën e Gjykatës ka qëndrime që bien ndesh me njëri-tjetrin, në kuptim të rolit si sovran, Kuvendi duhet të ketë një qëndrim të vetin. Sipas

përfaqësuesit të shumicës parlamentare, nën dritën e arsytimit të Gjykatës, krijohet ideja se kompetenca e Kuvendit në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës është barazuar me atë në pikën 2 të nenit 77, ku flitet për komisionet hetimore, kur në fakt diferenca në terma është se sipas pikës 4 të nenit 70, Kuvendi “vendos” për dërgimin e çështjes në Gjykatë, ndërsa sipas nenit 77 të Kushtetutës, Kuvendi “është i detyruar” të ngrejë komision.

52. Pas votimit, me vendimin nr. 41/2024, Kuvendi ka vendosur sërish mosdërgimin në Gjykatë të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

53. Gjykata vlerëson fillimisht të risjellë në vëmendje se në vendimin e saj nr. 1/2023, ajo ka konstatuar se gjatë procedurës së vlerësimit të raporteve përfundimtare të paraqitura për diskutim në seancën plenare të datës 17.11.2022 nga kërkuesi dhe shumica parlamentare, me vendimet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 Kuvendi ka vlerësuar se Gjykata nuk mund të investohej në shqyrtimin e çështjes, pasi nuk bëhej fjalë për veprime konkrete të deputetit që përbëjnë shkelje të nenit 70, pika 3, të Kushtetutës. Në lidhje me këtë qëndrim të Kuvendit, Gjykata ka vërejtur se çështja e vlerësimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, e cila nëpërmjet bashkëshortit mund të ketë ushtruar veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe të ketë fituar pasuri të këtyre, referuar fakteve, nuk i takon vlerësimit të Kuvendit, por vlerësimit të kësaj Gjykate, pasi ato (faktet) kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi duhej të kishte pranuar mocionin e kërkuesit dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në këtë Gjykatë, në mënyrë që aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes Olta Xhaçka t’i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u verifikua ndonjë pengesë juridiko-formale që mocioni të pengohej nga Kuvendi (*shih paragrafët 53, 54 dhe 56 të vendimit nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Referuar sa më lart, Gjykata rithekson se vendimi i saj nr. 1/2023 ka shprehur qartë detyrimin e Kuvendit që me vendim të dërgojë kërkesën për papajtueshmërinë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës para kësaj Gjykate, si organi i vetëm që do të shqyrtojë në themel faktet, për të përcaktuar nëse ato duhet të klasifikohen në parashikimet e pikës 2 ose pikës 3 të nenit 70, të Kushtetutës.

55. Në vijim, duke marrë shkas nga qëndrimet e subjektit të interesuar, si dhe të shumicës parlamentare gjatë procedurës së kundërshtuar, Gjykata çmon të ndalet fillimisht në analizën e parimit të mandatit të lirë (jodetyrues) të deputetit dhe të rolit të Kuvendit, si

interpretues i normave kushtetuese, të cilat janë paraqitur nga Kuvendi si shkaqe që përlligjin, sipas tij, vendimmarrjen e kundërshtuar në këtë gjykim.

56. Për qëllime të kësaj analize, Gjykata evidenton se normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si të izoluara, por duhen parë në harmoni me normat e tjera kushtetuese. Një qëndrim i tillë bazohet në faktin se asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete, pasi çdo dispozitë kushtetuese duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik, pa kontradikta të brendshme. Në leximin e Kushtetutës nevojitet harmonizimi i tekstit të saj integral dhe pajtimi i atyre dispozitave që mund të duket se krijojnë përplasje mes tyre (*shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

57. Në lidhje me pretendimin e Kuvendit se për vendimmarrjen e kundërshtuar ai është bazuar në parimin e mandatit të lirë të deputetit, Gjykata vëren se ai është parashikuar në nenin 70, pika 1, të Kushtetutës, i cili shprehet se deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues. Gjykata, në interpretimin e kësaj norme kushtetuese, ka pohuar se deputeti është mbajtës i mandatit të lirë dhe se mandati që i jepet atij ka si qëllim kryesor funksionimin sa më të mirë të parlamentit. Ky parim nënkupton se deputetit nuk i revokohet mandati nga zgjedhësit apo partia politike, ai nuk është i lidhur pas urdhrave të elektoratit dhe ai nuk detyrohet për të qenë apo mbetur pjesë e një grupi parlamentar të caktuar (*shih vendimin nr. 44, datë 07.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në të njëjtën linjë, Komisioni i Venecias ka pohuar se parimi i mandatit të lirë nënkupton edhe se deputeti mund të ndryshojë forcën politike në të cilën kishte aderuar ose të bëhet i pavarur pa pasur rrezikun e humbjes së mandatit. Mandati i lirë nënkupton, gjithashtu, se deputeti ka hapësirë për të votuar kundër edhe pa kaluar në mënyrë përfundimtare në një forcë tjetër politike (*shih opinionin e Komisionit të Venecias nr. 845/2016 CDL-AD(2019)015, datë 24.06.2019, § 51*).

58. Mbi bazën e këtyre standardeve, Gjykata vlerëson se parimi kushtetues i mandatit të lirë të një deputeti nuk mund të kuptohet si liri absolute e tij, që nuk kufizohet nga Kushtetuta dhe ligjet, për të vepruar në një mënyrë të tillë që Kuvendi të mos jetë në gjendje të zbatojë kërkesat që burojnë nga Kushtetuta dhe të miratojë vendime të papajtueshme me të. Prandaj, Gjykata çmon se parimi i mandatit të lirë (jodetyrues), edhe pse është i zbatueshëm në procedurat parlamentare kur deputetët thirren në votim, nuk nënkupton se liria në votim e deputetit është absolute. Përkundrazi, kjo liri në votim e tij u nënshtrohet kufizimeve që

rrjedhin nga parimet e supremacisë së Kushtetutës, të shtetit të së drejtës dhe të kushtetutshmërisë, element i të cilave është edhe detyrueshmëria e zbatimit të vendimeve të Gjykatës. Në këtë kuptim, parimi i mandatit të lirë të deputetit nuk mund të shtrihet në çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e vendimeve të Gjykatës në rastet kur ajo ka përcaktuar për Kuvendin detyrime konkrete që nuk lënë hapësirë vlerësimi për mënyrën e zbatimit nga ana e tij.

59. Për sa i takon rolit të Kuvendit si interpretuesi i parë i normës kushtetuese, Gjykata çmon të ndalet në kufijtë e interpretimit të Kuvendit. Edhe pse në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Kuvendi shfaqet edhe si interpretuesi i parë i normës kushtetuese (*shih vendimet nr. 16, datë 27.06.2022; nr. 9, datë 01.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), ky organ mund të ndërhyjë deri atje dhe vetëm për ato çështje që Gjykata nuk është shprehur, si organi i vetëm që bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës sipas nenit 132 të saj. Nëse kjo ka ndodhur, Kuvendi nuk mund të ushtrojë më rolin e interpretuesit të parë të normës kushtetuese.

60. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se një interpretim i ndryshëm i parimit të mandatit të lirë (jodetyrues) të deputetit dhe të rolit të Kuvendit, si interpretues i normave kushtetuese, në rastin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, passjell mundësinë e përplasjes mes dispozitave kushtetuese, krijimin e kontradiktave të brendshme dhe cenimin e harmonisë në sistemin e normave kushtetuese, çka është e palejueshme për rendin kushtetues, pasi vë në dyshim epërsinë e Kushtetutës, rezultat që nuk pajtohet me parimin e shtetit të së drejtës dhe atë të kushtetutshmërisë, të cilat i detyrojnë të gjitha organet e pushtetit publik, përfshirë edhe Kuvendin, që t'i ushtrojnë funksionet e tyre brenda kufijve kushtetues.

61. Bazuar në sa më lart, në rastin konkret, në lidhje me pretendimin për mandatin jodetyrues të deputetit, Gjykata vlerëson se procedura e vendimmarrjes së Kuvendit, që është kundërshtuar në këtë gjykim dhe votimi i deputetëve në atë rast, nuk mund të përliqet me parimin e mandatit jodetyrues të deputetit, për shkak se zbatimi i vendimit të Gjykatës nuk është një çështje politike, rast në të cilin Kuvendi ka hapësirë vlerësimi dhe deputeti gëzon lirinë e zgjedhjes së qëndrimit përmes votimit sipas mandatit të lirë. Nisur nga kjo, Gjykata vlerëson se Kuvendi nuk ka vepruar në përputhje me Kushtetutën për sa kohë çështjen e ekzekutimit të vendimit të saj ia ka nënshtruar vlerësimin të Këshillit për Legjislacionin dhe Këshillit për Mandatet, struktura në të cilat shumica parlamentare ka vënë në dyshim fuqinë detyruese të vendimit të Gjykatës, ka thirrur ekspert të jashtëm dhe, më pas, ka vlerësuar se çështja duhet t'i përcillet për votim seancës plenare, votim në të cilin gjente zbatim parimi i

mandatit jodetyrues. Gjykata thekson se zbatimi i vendimit të saj në rastin konkret nuk është një procedurë e zakonshme parlamentare, por një procedurë për ekzekutimin e një detyrimi konkret të lindur prej tij, sikurse është ai për dërgimin asaj të çështjes së papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka të ngritur mbi mocionin e 1/10-ës së deputetëve, ndaj qëndrimi i Kuvendit në këtë drejtim është i pabazuar.

62. Po ashtu, në lidhje me pretendimin për rolin e Kuvendit si interpretues i normave kushtetuese, Gjykata vlerëson se Kuvendi në rastin konkret shfaqet në pozitat e çdo organi/institucioni që është i detyruar të veprojë në përputhje me përcaktimet e vendimit të saj. Ai nuk ka hapësirë për interpretimin e normave kushtetuese, pasi nuk është në pozitat e interpretuesit të parë dhe origjinal të tyre, për sa kohë që për çështjen konkrete është shprehur Gjykata, e cila në vendimmarrjen e saj ka konstatuar se mocioni i jo më pak se 1/10-ës së deputetëve plotëson kriteret juridiko-formale për vënien e saj në lëvizje nga Kuvendi, ndaj ky i fundit nuk ka pasur hapësirë për të vlerësuar sërish ato, çka për pasojë bën të pabazuar edhe këtë qëndrim të Kuvendit.

63. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se Kuvendi nuk ka respektuar vendimmarrjen e Gjykatës, në kundërshtim me detyrimin kushtetues që buron nga neni 132 i Kushtetutës. Duke mos respektuar këtë detyrim, Kuvendi ka shkaktuar një mosmarrëveshje të re kushtetuese, pasi, përmes vendimmarrjes së tij, ka cenuar të drejtën kushtetuese të jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, duke penguar mocionin e tyre pavarësisht mosekzistencës së pengesave juridiko-formale. Ky refuzim i Kuvendit për zbatimin e vendimit të Gjykatës ka çuar në krijimin e një krize kushtetuese që jo vetëm cenon themelet e shtetit demokratik dhe humb besimin e publikut të shteti dhe organet e tij, por vë në diskutim edhe vetë rolin dhe funksionin e Gjykatës.

64. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata çmon se pretendimet e subjektit jo më pak se 1/10-ta e deputetëve janë të bazuara, ndaj kërkesa e tij duhet të pranohet, duke zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet këtij subjekti dhe Kuvendit, shfuqizuar vendimin nr. 41/2024 të Kuvendit si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe detyruar Kuvendin për dërgimin në Gjykatë të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

65. Ndërkohë, Gjykata, në kontekst të rrethanave të rastit dhe në raport me përcaktimet e nenit 66/a, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 në lidhje me afatin maksimal të paraqitjes asaj të

kërkesës nga Kuvendi, konsideron të theksojë se shqyrtimi i çështjes nga Kuvendi duhet të bëhet me përparësi, për t'i hapur rrugë ushtrimit nga Gjykata të kompetencave të saj.

II. Për kërkesën e subjektit jo më pak se 1/5-ta e deputetëve

66. Në lidhje me kërkesën e kërkuarit jo më pak se 1/5-ta e deputetëve, për interpretimin përfundimtar të neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se në rastin konkret interpretimi i këtyre dispozitave kushtetuese ka marrë përgjigje në arsyetimin e mësipërm të këtij vendimi, i cili ka mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e saj të mëparshme. Për rrjedhojë, ajo vlerëson të mos ndalet në analizimin e kriterëve paraprake dhe themelin e çështjes³.

67. Në përfundim, nisur nga fakti që objekti i këtij shqyrtimi lidhej me kërkime të veçanta të dy subjekteve të ndryshme, ku vetëm njëri kërkim u gjet i bazuar, Gjykata çmon se për sa i përket kërkesës në tërësi, ajo duhet të pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “ç”, si dhe neneve 54, 55, 56, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt jo më pak se 1/10-ta e deputetëve.
3. Shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024, datë 11.04.2024 “Për mosdërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

³ Gjyqtarja Elsa Toska mbajti qëndrimin se kërkuari jo më pak se 1/5-ta e deputetëve nuk legjitimohet *ratione personae* as si subjekt në konflikt në mosmarrëveshjen e kompetencës, as për iniciimin e gjykimit kushtetues me objekt papajtueshmërinë e ushtrimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, qëndrim ky në të njëjtën linjë me qëndrimin në pakicë në vendimin nr. 2, datë 23.01.2023 të Gjykatës. Për rrjedhojë, subjekti kushtetues jo më pak se 1/5-ta e deputetëve nuk legjitimohet as për interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese objekt kundërshtimi.

4. Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të mocionit për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.07.2024

Shpallur më 30.07.2024

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues jo më pak se 1/10-ta e deputetëve të Kuvendit dhe jo më pak se 1/5-ta e deputetëve të tij (*kërkuesit*) bashkohem me qëndrimin e shumicës vetëm për sa i përket pikës 1 të dispozitivit të vendimit, konkretisht pranimit pjesërisht të kërkesës. Kështu, për sa i përket kërkesës së 1/10-ës së deputetëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës mes këtij subjekti dhe Kuvendit, jam kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur për pranimin e kësaj kërkesë, zgjidhjen e konfliktit/mosmarrëveshjes së kompetencës dhe shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024 të Kuvendit, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Ndërkohë, vlerësoj se duhej të ishte pranuar kërkesa e 1/5-ës së deputetëve për interpretimin e dispozitave kushtetuese, ndërsa kërkimi i këtij subjekti kushtetues për konstatimin e papajtueshmërisë me nenin 70, pika 3, të Kushtetutës të mandatit të deputetes Olta Xhaçka duhej të ishte shqyrtuar në themel. Argumentet e mia në këtë drejtim janë të njëjta me ato të parashtruara në qëndrimin në pakicë që kam shprehur në vendimin nr. 1/2023 të Gjykatës, për sa i përket legjitimitit të 1/10-ës së deputetëve, si subjekt kushtetues. Ndërsa, për sa i takon legjitimitit të 1/5-ës së deputetëve për interpretimin e dispozitave kushtetuese, argumentet e mia mbështeten në jurisprudencën e konsoliduar të kësaj Gjykate. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim më në detaj argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër në çështjen konkrete.

2. Kështu, në datën 24.04.2024 Gjykata është vënë në lëvizje nga kërkuesit, ku 1/10-ta e deputetëve ka kërkuar, në thelb, zgjidhjen e konfliktit të kompetencës së krijuar, si rrjedhojë e moszbatimit nga Kuvendi të vendimeve nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023 të Gjykatës, përmes të cilave ishte përcaktuar detyrimi i këtij organi për dërgimin në Gjykatë të çështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhaçka, në mungesë të pengesave juridiko-formale të mocionit të 1/10-ës së deputetëve, si dhe se ishte Gjykata ajo që do të vlerësonte në themel nëse deputetja në fjalë, përmes bashkëshortit të saj, kishte kryer veprimtari fitimprurëse që buronin nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor ose kishte fituar pasuri të këtyre dhe nëse veprimet/mosveprimet e deputetes, përmes bashkëshortit të saj, përbënin shkelje të pikës 2 ose pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

3. Në të njëjtën kërkesë, 1/5-ta e deputetëve ka kërkuar interpretimin përfundimtar të neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës, duke pretenduar, në thelb,

se vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit e bën të nevojshëm interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese, si dhe se Gjykata duhet të përcaktojë nëse parimi i mandatit të lirë, jo detyrues, të deputetit, i sanksionuar në nenin 70, pika 1, të Kushtetutës shtrihet edhe ndaj vendimeve të saj.

4. Në lidhje me kërkimin e 1/10-ës së deputetëve për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, subjektet e interesuara, Kuvendi dhe deputetja Olta Xhaçka, kanë prapësuar se 1/10-ta e deputetëve nuk përbën subjekt kushtetues, pasi nuk është veshur nga Kushtetuta me kompetenca për të vendosur për çështje konkrete. Kompetenca për të vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatë, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës dhe jurisprudencës kushtetuese i takon vetëm Kuvendit, i cili nuk është i detyruar të vendosë në këtë mënyrë vetëm për shkak se është vënë në lëvizje nëpërmjet mocionit. Në këtë kuptim, nuk mund të thuhet se ekziston një mosmarrëveshje kushtetuese mes këtij subjekti dhe Kuvendit. Po sipas subjekteve të interesuara, në rastin e deputetes Xhaçka, në zbatim të nenit 70, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës, Kuvendi ka shqyrtuar nëse mocioni i paraqitur nga jo më pak se 1/10-ta e deputetëve plotësonte kushtet formale të kërkuara, pa analizuar në themel prova ose fakte, kompetencë që i takon Gjykatës. Në përfundim ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në mocion kishin të bënin me parashikimet e nenit 70, pika 2, të Kushtetutës dhe nenet 21 e 24 të ligjit nr. 9367/2005, të cilat nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, ndaj nuk mund të vendoste dërgimin e çështjes në Gjykatë.

5. Në lidhje me kërkimin e bërë nga subjekti i pakushtëzuar, 1/5-ta e deputetëve, Kuvendi ka prapësuar se, për sa kohë që nuk ka një mosmarrëveshje konkrete kushtetuese, 1/5-ta e deputetëve nuk legjitimohet të kërkojë *in abstracto* interpretimin e dispozitave kushtetuese. Pika 1 e nenit 70 të Kushtetutës ka të bëjë me llojin e mandatit përfaqësues të deputetit dhe nuk gjen zbatim në rastin konkret. Po kështu, as parashikimet e pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës nuk gjejnë zbatim në çështjen në shqyrtim, ndërsa pikat 3 dhe 4 të këtij neni kanë të bëjë me rastet kur vetë deputetët kryejnë veprimtari ekonomike që buron nga pasuria shtetërore ose e pushtetit vendor. Edhe sipas deputetes Olta Xhaçka, pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës kërkon që vetë deputeti, me veprimet e tij, të ketë kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor ose të ketë fituar pasuri të këtyre organeve dhe jo familjarët e tij, ndërsa neni 70, pika 4, i Kushtetutës, në ndryshim nga neni 77, pika 2, i saj, nuk e detyron Kuvendin të miratojë mocionin e pakicës dhe të vendosë për dërgimin e çështjes në Gjykatë.

6. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se një mosmarrëveshje kompetence që i paraqitet për zgjidhje, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, duhet të ketë

natyrë kushtetuese, në kuptimin që subjektet e përfshira në konflikt të jenë nga ato që njeh Kushtetuta dhe që kompetenca e pretenduar të parashikohet si e tillë. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatë përqendrohet, pikësisht, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës për sa u takon funksioneve të nivelit kushtetues (*shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në vendimin për çështjen, shumica ka vlerësuar se, referuar deputetëve konkretë nënshkrues të 2 mocioneve drejtuar Kuvendit për papajtueshmërinë me mandatin të deputetes Olta Xhaçka dhe atyre nënshkrues të kërkesës drejtuar Gjykatës, 1/10-ta e deputetëve legjitimohet *ratione personae* në kërkesën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së krijuar mes saj dhe Kuvendit, si rrjedhojë e vendimit nr. 41/2024 të këtij të fundit, pasi kërkesa drejtuar Gjykatës mban nënshkrimin e të paktën 14 deputetëve, të cilët kanë vënë në lëvizje procedurën parlamentare për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes. Po sipas gjyqtarëve në shumicë, 1/10-ta e deputetëve legjitimohet edhe *ratione temporis* e *ratione materiae*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 6-mujor të parashikuar nga neni 55 i ligjit nr. 8577/2000 dhe pretendimet e parashtruara nga ky subjekt përfshihen në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafët 32-35 të vendimit të Gjykatës*). Në lidhje me thelbin e kërkesës, shumica ka vlerësuar se vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit ka shkaktuar një mosmarrëveshje të re kushtetuese, pasi ka cenuar të drejtën kushtetuese të jo më pak se 1/10-ës së deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhaçka, pavarësisht mosekzistencës së pengesave formale, si dhe ka çuar në krijimin e një krize kushtetuese, çka jo vetëm cenon themelet e shtetit demokratik dhe humb besimin e publikut te shteti dhe organet e tij, por vë në diskutim edhe vetë rolin dhe funksionin e Gjykatës (*shih paragrafin 63 të vendimit*).

8. Në rastin konkret, ashtu siç kam theksuar në mendimin tim të pakicës në vendimin nr. 1/2023 të Gjykatës, vlerësoj se shumica nuk ka arritur të identifikojë kompetencën kushtetuese që i është cenuar 1/10-ës së deputetëve dhe se ajo i përket pikërisht këtij grupimi parlamentar, ose të argumentojë se si e drejta e 1/10-ës së deputetëve për vënien në lëvizje të Gjykatës për papajtueshmërinë me mandatin të deputetes konvertohet në një kompetencë kushtetuese, e cila në këtë rast është marrë nga Kuvendi, pra është mohuar ose është ushtruar nga vetë ky i fundit. Neni 70, pika 4, i Kushtetutës garanton të drejtën e 1/10-ës së deputetëve për të vënë në lëvizje procedurat parlamentare për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit nga deputeti dhe jo të drejtën e këtij subjekti për të vënë në lëvizje Gjykatën,

kompetencë të cilën dispozita kushtetuese ia ka njohur vetëm Kuvendit. Ndërkohë, krahas Kuvendit, neni 66, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000 ia ka njohur këtë të drejtë edhe 1/5-ës së deputetëve, duke parashikuar se për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, Gjykata vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit ose 1/5-ës së deputetëve.

9. Referuar edhe jurisprudencës kushtetuese të mëparshme (përpara vendimit nr. 1/2023 të Gjykatës), 1/10-ta e deputetëve, si subjekt kushtetues, nuk rezulton t'i jetë drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave në raste të ngjashme që lidhen me papajtueshmërinë e mandatit, duke mos e legjitimuar veten më parë si subjekt në një konflikt të tillë me natyrë kushtetuese. Edhe pse ky subjekt ka marrë pjesë në gjykimin kushtetues në disa çështje që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë e mandatit të deputetit, rezulton që ai të jetë thirrur nga Gjykata si subjekt i interesuar (me kërkesë ose kryesisht) në kuptim të nenit 39, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, si subjekt që ka pasur interes të drejtpërdrejtë në çështje dhe jo si subjekt në mosmarrëveshje për kompetencë, në kuptim të shkronjës "ç" të këtij neni (*shih vendimet nr. 72, datë 07.12.2016; nr. 32, datë 03.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në këtë situatë, vlerësoj se shumica duhej të kishte arsytuar për elementet e mosmarrëveshjes së kompetencave, si dhe nëse në rastin konkret Kuvendi, si pushtet ligjvënës, kishte vlerësuar dhe vendosur për çështje që janë kompetencë e pakicës parlamentare, në kuptim të përmbajtjes së nenit 70 të Kushtetutës, si dhe nenit 119/1, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, i cili i ka njohur Kuvendit kompetencën që, përmes Këshillit për Mandatet, të verifikojë si plotësimin e kërkesave juridiko-formale të mocionit të paraqitur, ashtu edhe nëse mocioni plotëson kriteret e parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës për vënien në lëvizje të Gjykatës, konkretisht nëse vetë deputeti/ja, dhe jo bashkëshorti/ja i tij/saj, ka kryer veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose ka fituar pasuri të këtyre. Pra, shumica duhej të bënte një analizë të hollësishme të kompetencës kushtetuese të secilit organ dhe të shkaqeve që kanë krijuar mosmarrëveshjen e pretenduar të kompetencës ndërmjet dy subjekteve kushtetuese, duke qenë se detyrë e kësaj Gjykate është zgjidhja e këtyre mosmarrëveshjeve përmes eliminimit të shkaqeve që i kanë lindur ato. Duke mos përcaktuar se cila është kompetenca kushtetuese e 1/10-ës së deputetëve, pra pozicionin e 1/10-ës në konfliktin e pretenduar kushtetues, shumica nuk ka arritur të eliminojë shkaqet e mosmarrëveshjes së pretenduar të kompetencave. Qëndrimi i shumicës për pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit nr. 41/2024 të Kuvendit, pa përcaktuar nëse ai është marrë në

kundërshtim me kompetencat e këtij organi ose me jurisprudencën kushtetuese, e cila ka përcaktuar rast pas rasti se cili është organi kompetent për të vendosur për këtë çështje, përbën devijim nga jurisprudenca e konsoliduar kushtetuese.

11. Në këtë këndvështrim, në çështjen në shqyrtim, çmoj se duhej të ishte vendosur rrezimi i kërkesës së 1/10-ës së deputetëve, pasi, në rastin konkret, Kuvendi ka vepruar në përputhje me kompetencat e veta kushtetuese dhe vendimi nr. 41/2024 nuk rezulton të ketë krijuar mosmarrëveshje kompetencash mes tij dhe 1/10-ës së deputetëve. Nga ana tjetër, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, të drejtën për të nisur kontrollin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, neni 66, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000 ia ka njohur, së pari, Kuvendit dhe, në rast të mosveprimit të tij, një subjekti tjetër që është 1/5-ta e deputetëve, duke parashikuar se për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, Gjykata vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit ose 1/5-ës së deputetëve. Pra, vetë ligjvënësi, përmes ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 8577/2000 në vitin 2016, ka përcaktuar ushtrimin e së drejtës së 1/5-ës së deputetëve të parashikuar në këtë dispozitë ligjore si mënyrën e vetme për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues në rast se Kuvendi nuk vepron në përputhje me detyrimin kushtetues të përcaktuar në pikën 4 të nenit 70 të Kushtetutës.

12. Po kështu, nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës edhe për sa i përket mosshqyrtimit të kërkesës së 1/5-ës së deputetëve për interpretimin e neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës. Shumica ka vlerësuar të mos ndalet në analizimin e kritereve paraprake dhe themelit të çështjes në lidhje me këtë kërkim, pasi ai ka marrë përgjigje në arsyetimin e vendimit, i cili ka mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e mëparshme kushtetuese (*shih paragrafin 66 të vendimit*).

13. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se 1/5-ta e deputetëve përfaqëson një nga subjektet e parashikuara në nenin 134, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, që kanë të drejtë të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues për arsye të një interesi publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret. Interesi i këtyre funksionarëve publikë për të mbrojtur sistemin normativ dhe parimet shtetformuese, si, konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë, nuk është i kushtëzuar (*shih vendimet nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po sipas Gjykatës, interpretimi i ligjit themelor të shtetit është funksioni kryesor i saj dhe ajo e ushtron këtë kompetencë sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese, sepse gjatë këtij kontrolli është i nevojshëm, në çdo rast, interpretimi i kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim (*shih vendimet nr. 29, datë 30.06.2011; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Interpretimi i ligjit themelor, përveçse një kompetencë e veçantë e Gjykatës, e cila i trajton çështje të tilla si kërkesa të mëvetshme, kryhet edhe në çdo rast tjetër kur ajo vepron në kuptim të kompetencave kushtetuese sipas nenit 131 të Kushtetutës, që ushtrohen në zbatim dhe interpretim të normës kushtetuese, që do të thotë edhe pa qenë nevoja të vihet në lëvizje me kërkesë të veçantë. Në jurisprudencën e saj në këtë drejtim Gjykata ka përcaktuar kritere të veçanta nga rastet e tjera, duke theksuar se në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës duhet të plotësohen disa kushte: *së pari*, norma që kërkohet të interpretohet duhet të jetë e paqartë dhe si pasojë e kësaj paqartësie që ajo mbart dhe kuptimit që i është dhënë ka lindur një “problem/mosmarrëveshje kushtetues/e; *së dyti*, kërkohet të ekzistojë një marrëdhënie e ngushtë ndërmjet normës konkrete kushtetuese dhe fakteve, mosmarrëveshjeve ose çështjeve të përcaktuara konkretisht në një ose disa akte të organit kompetent, si pasojë e zbatimit ose kuptimit të padrejtë të kësaj norme kushtetuese; *së treti*, kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme. Qëndrimet e mbajtura nga një organ për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të mjaftueshme për kryerjen e një interpretimi përfundimtar (*shih vendimet nr. 29, datë 30.06.2011, nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në çështjen në shqyrtim vlerësoj se, pikësëpari, shumica duhej të kishte arsyetuar dhe vlerësuar legjitimitimin e 1/5-ës së deputetëve për interpretimin e dispozitave kushtetuese. Kjo për shkak se, jo vetëm që në vendimin nr. 2/2023 të Gjykatës, në thelb, shumica ka mbajtur qëndrimin se ky subjekt kushtetues nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën për papajtueshmërinë me nenin 70, pika 3, të Kushtetutës të mandatit të deputetit, pasi juridiksioni i Gjykatës për shkelje të kësaj pike aktivizohet vetëm me kërkesë të Kuvendit (*shih paragrafin 34 të vendimit nr. 2, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), por edhe për faktin se, në çështje të ngjashme për interpretimin e dispozitave kushtetuese, ka vlerësuar se 1/5-ta e deputetëve nuk legjitimohet t'i

drejtohet Gjykatës as për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje kushtetuese në të cilën nuk është palë ose e cila nuk cenon ushtrimin e funksioneve të saj (*shih vendimin nr. 273, datë 20.12.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*), pavarësisht se jurisprudenca e mëparshme kushtetuese e ka legjitimuar këtë subjekt për të kërkuar interpretimin e dispozitave kushtetuese, pa pasur nevojë të argumentojë dhe justifikojë interesin e saj në çështje konkrete (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 75, datë 19.04.2002; nr. 28, datë 21.02.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në referim të rastit konkret, vetë shumica ka pranuar se mosveprimi i Kuvendit për zbatimin e vendimeve nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023 të Gjykatës ka çuar në krijimin e një mosmarrëveshjeje kushtetuese. Pikërisht për këtë shkak, duke qenë se Kuvendi dhe pakica parlamentare kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me përcaktimet e dispozitave kushtetuese, në kërkesën drejtuar Gjykatës 1/5-ta e deputetëve ka kërkuar interpretimin përfundimtar të tyre. Sipas 1/5-ës së deputetëve, vendimi nr. 41/2024 i Kuvendit ka cenuar të drejtën e pakicës parlamentare për t'iu drejtuar Gjykatës për çështje të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, ndërsa sipas Kuvendit, ai nuk është i detyruar të dërgojë çështjen në Gjykatë në çdo rast, pasi detyrimi i deputetëve për të vendosur në mënyrë formale, duhet të shihet në pajtueshmëri ose jo me paragrafin 1 të nenit 70, sipas të cilit mandati i deputetit nuk është i detyrueshëm. Në këto kushte, Gjykata duhej të bënte interpretimin përfundimtar të neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës.

18. Duke qenë se plotësoheshin të tria kriteret e vendosura nga Gjykata për interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese, pasi kishte lindur një mosmarrëveshje kushtetuese, ndërmjet normave kushtetuese që kërkoheshin të interpretoheshin dhe mosmarrëveshjes kushtetuese ekzistonte një lidhje e ngushtë dhe subjektet në konflikt kishin mbajtur qëndrimet e tyre për kuptimin e normave kushtetuese, çmoj se 1/5-ta e deputetëve kishte arritur të justifikonte nevojën për një interpretim përfundimtar nga Gjykata, vendimi i së cilës do të ishte detyrues për zbatim në këtë rast.

19. Krahas faktit se, referuar jurisprudencës kushtetuese, e drejta e 1/5-ës së deputetëve për të kërkuar interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese lidhet pikërisht me rolin që ky subjekt ka në mbrojtjen e interesit publik, pa u kushtëzuar me një interes subjektiv konkret dhe se vetë Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka analizuar arsyet se përse ky grupim vjen në këtë gjykim në ndryshim nga çdo grupim tjetër parlamentar, pa pasur nevojë të argumentojë dhe justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete, ky qëndrim i imi mbështetet

edhe në faktin se, në rastin konkret, kërkimi për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërlidhej me interpretimin e dispozitave kushtetuese dhe jo *vice versa*, ndaj kërkesa e 1/5-ës së deputetëve për interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese nuk duhej të ishte shmangur nga analiza dhe arsyetimi i vendimit.

20. Po në këtë drejtim, çmoj të vë në dukje se, në lidhje me këtë kërkim të 1/5-ës së deputetëve, konkretisht interpretimin e neneve 70, pikat 1 dhe 4, 73, pika 1 dhe 132, pika 1, të Kushtetutës, shumica ka arsyetuar se ai ka marrë përgjigje në vendim, i cili ka mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën kushtetuese. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se, pavarësisht jurisprudencës së mëparshme të Gjykatës për interpretimin e nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, çështja kërkonte interpretim përfundimtar në këndvështrim të raportit mes kësaj dispozite kushtetuese, e cila përcakton detyrimin e Kuvendit për dërgimin në Gjykatë të mocionit të 1/10-ës së deputetëve për papajtueshmërinë me pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës të mandatit të deputetit, me parashikimet e pikës 1 të nenit 70 të Kushtetutës, që përcakton parimin e mandatit jodetyrues të deputetit. Nga ana tjetër, vlerësoj, gjithashtu, se arsyetimi i përdorur nga shumica në vendim për këtë kërkim të 1/5-ës ka evituar dhënien e një përgjigjeje në lidhje me legjitimitimin e këtij subjekti kushtetues, ndërkohë që duhet të kishte mbajtur qëndrim të arsyetuar në këtë drejtim.

21. Përveçse për sa më lart, krahas interpretimit përfundimtar të normave kushtetuese, në pretendimet e këtij subjekti është pasqyruar edhe kërkimi për konstatimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të mandatit të deputetes Olta Xhaçka. Ashtu siç theksova edhe më sipër (*shih paragrafin 11*), neni 66, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000 i ka parashikuar dy subjekte që mund të vënë në lëvizje Gjykatën për shqyrtimin e papajtueshmërisë me mandatin të deputetit, konkretisht Kuvendin dhe, në rast të mosveprimit të tij, edhe 1/5-ën e deputetëve. Po kështu, e drejta e 1/5-ës e përcaktuar në këtë dispozitë të ligjit është pranuar në gjykim edhe nga përfaqësuesi i deputetes Olta Xhaçka. Ndaj, në këto kushte, krahas kërimit për interpretimin e dispozitave konkrete të Kushtetutës, në vendim shumica duhej të kishte dhënë përgjigje edhe për këtë kërkim. Mungesa e një arsyetimi të shumicës në këtë drejtim dhe mosdhënia përgjigjeje në thelb të kërimit të 1/5-ës së deputetëve në lidhje me papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka do të krijonte një *impass* të tillë, i cili do të përkthehej në një krizë kushtetuese.

22. Në përmbledhje të sa më sipër, në rastin konkret, çmoj se Gjykata duhej të kishte vendosur rrëzimin e kërkesës së 1/10-ës së deputetëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së

kompetencës, pasi, ashtu siç parashtrova më lart, nuk ndodhemi përpara një konflikti kompetencash (*shih paragrafët 10-11*), ndërkohë që duhej të kishte pranuar kërkesën e 1/5-ës së deputetëve për interpretimin përfundimtar të dispozitave kushtetuese, si subjekt i pakushtëzuar për vënien në lëvizje të Gjykatës, si dhe të kishte dhënë përgjigje për pretendimet e këtij subjekti në lidhje me mandatin e deputetes Olta Xhaçka.

Anëtare: Sonila Bejtja